

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	77 të vdekur gjatë 8 muajve, ekspertët tregojnë shkaqet kryesore
ADRESA	https://indeksonline.net/77-te-vdekur-ne-tete-muaj-ekspertet-tregojne-shkaqet-kryesore/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 06:43:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	6 shtator 2026, 22:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 6 shtator 2026, 21:59:00 UTC → 6 shtator 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1b581b06cac1859554d84df00878800eb08c966d9543d952207a6d29606613a5
TEKSTI	1e3ba8cf9ef2bb0d71fb4598aa81e96caba5dec6eb3dd349a5c1b72f41bb22c
PAMJA	9faa5b5c6e9a5f844471cf187ac9cec9f60e4e8be11ea5f24e602086c4d778e4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f48c3edc0fafd40b47635169eeddd88e74dd86a1e0de58f57474bd7d88508255
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	cae791e3aa00c35889555c700c23f70e42f4133ad0851613176cd0c76c652be7
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmaTJq3d3L2Lnk9ysZtPZFh9yq1NEa5sUsFa8GtiZPGAjo



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f48c3edc0fafd40b47635169eeddd88e74dd86a1e0de58f57474bd7d88508255>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px


- [Ballina](#)
- [Lajme](#)
- [Sport](#)
- [Showbiz](#)
- [Tech](#)
- [Auto](#)
- [Kuriozitete](#)
- [Indeks+](#)
- [Ekonomi](#)
- [Shëndetësi](#)
- [Zgjedhjet](#)
- [Opinion](#)

Kërko produktin...

SHPËRNDAJE

08:43 / E Hënë, 07 Shtator 2026 / Z S

77 të vdekur gjatë 8 muajve, ekspertët tregojnë shkaqet kryesore



Tre persona humbën jetën vetëm gjatë së enjtes në aksidente të ndryshme trafiku në Kosovë.

Një 17-vjeçar u godit për vdekje nga një veturë në rrugën Ferizaj–Prishtinë, ndërsa një tjetër person humbi jetën në një aksident mes një veture dhe një motoçiklete në Llukar të Prishtinës.

Një tjetër aksident me fatalitet ishte raportuar edhe në vendin e ngjarjes në Istog.

Kosova vazhdon të përballlet me një situatë shqetësuese në trafikun rrugor.

Vetëm gjatë periudhës janar–gusht 2026 janë regjistruar 72 aksidente fatale, katër më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Policia e Kosovës ka bërë të ditur për Front Onlinen se gjatë vitit 2025 janë regjistruar 733 aksidente trafiku ku kanë qenë të përfshira mjete me dy rrota, ndërsa 12 prej tyre kanë përfunduar me fatalitet.

Brenda tetë muajve të parë të vitit 2026, numri i aksidenteve të tilla ka arritur në 541, prej të cilave 14 kanë qenë fatale.

“Gjatë periudhës janar – gusht 2026 nga 541 aksidente ku të përfshira kanë qenë mjetet me dy rrota, 14 prej tyre kanë qenë me fatalitet”, thuhet në deklaratë.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, pavarësisht se numri i përgjithshëm i aksidenteve me mjete me dy rrota deri në gusht të këtij viti është më i ulët krahasuar me tërë vitin 2025, numri i aksidenteve me fatalitet është rritur.

“Gjatë vitit 2025 në aksidente të trafikut të përfshira kanë qenë edhe mjetet me dy rrota ku janë regjistruar 733 aksidente, 12 prej tyre kanë përfunduar me fatalitet”, thuhet në përgjigjen e Policisë së Kosovës.

Edhe më alarmues është fakti se 77 persona kanë humbur jetën në aksidente trafiku gjatë katyre tetë muajve.

Të dhënat e siguruara nga Policia e Kosovës, në përgjigje të kërkesës së Front Onlinet, tregojnë se pavarësisht rënies së numrit të përgjithshëm të aksidenteve, aksidentet me fatalitet kanë shënuar rritje prej 5.88 për qind.

Pra, në rrugët e Kosovës gati 10 persona në muaj kanë humbur jetën në aksidente trafiku gjatë tetë muajve të parë të këtij viti.

Ndërkohë, aksidentet me lëndime janë rritur nga 5,927 në 6,018 raste, një rritje prej 1.54 për qind.

Në këto aksidente, numri i personave të lënduar ka rënë nga 11,393 në 11,110, apo 283 persona më pak (-2.48%).

Rënia më e madhe është shënuar te aksidentet me dëme materiale, të cilat nga 10,421 raste në janar–gusht 2025 kanë zbritur në 9,122 raste në të njëjtën periudhë të vitit 2026, ose 1,299 raste më pak (-12.47%).

Eksperti i komunikacionit: Faktori njeri dhe infrastruktura po ndikojnë në rritjen e aksidenteve

Eksperti i komunikacionit, Naser Lajqi ka thënë për Front Onlinen se rritja e numrit të aksidenteve në trafik është rezultat i dy faktorëve kryesorë.

“Fenomeni i fundit me rritjen e rasteve të aksidenteve është si pasojë e faktorit njeri dhe infrastrukturës rrugore”, ka deklaruar Lajqi.

Sipas tij, shoferët duhet të tregojnë kujdes të shtuar, duke respektuar rregullat dhe shenjat e trafikut.

“Faktori njeri duhet të përgatitet që nga faza e parë në autoshollë e gjatë drejtimit të automjetit duhet të ketë kujdes të shtuar ose t’i zbatojnë rregullat e trafikut dhe shenjat t’i respektojnë”, tha ai.

Lajqi ka kritikuar edhe infrastrukturën rrugore, duke theksuar se gjendja e tillë po ndikon në sigurinë e pjesëmarrësve në trafik.

“Infrastrukturat rrugore po sillin shumë aksidente. nuk kanë as sinjalizime në rrugë. fatkeqësisht nuk kemi ditë që s’ka aksidente me të lënduar. e lëre më me fatalitet”. u shpreh eksperti i komunikacionit.

komunikacionit.

Shkelja e rregullave në trafik/ Policia: Janë shqiptuar gjoba dhe janë konfiskuar mjete

Policia e Kosovës ka theksuar për Front Onlinen se masat ndaj drejtuesve të mjeteve me dy rrota janë marrë në kuadër të zbatimit të ligjeve dhe rregullave të trafikut.

“Në zbatim të ligjeve në fuqi Policia e Kosovës shqipton gjoba për të gjitha llojet e kundërvajtjeve pa specifikuar llojin e mjetit”, thuhet në përgjigjen e policisë.

Sipas saj, në kuadër të këtyre masave janë përfshirë edhe mjetet me dy rrota që janë hasur në trafik duke shkelur rregullat.

“Pa dyshim që janë gjobitur e konfiskuar edhe mjetet me dy rrota të cilat janë hasur në trafik në kundërshtim me rregullat e trafikut”, deklaroi Policia e Kosovës.

Policia ka bërë thirrje që për masat e marra ndaj këtyre mjeteve t’u referohet edhe postimeve të saj të përditshme në rrjetet sociale.

Përveç masave ndëshkuese, Policia e Kosovës thotë se gjatë vitit 2025 dhe gjatë këtij viti ka zhvilluar fushata vetëdijësuese për sigurinë në trafikun rrugor.

“Gjatë vitit 2025 dhe në këtë periudhë të vitit 2026, Policia e Kosovës ka zhvilluar vazhdimisht fushata vetëdijësuese lidhur me sigurinë në trafikun rrugor”, thuhet në deklaratë.

Sipas policisë, në këto fushata kanë qenë të përfshira edhe aktivitetet sensibilizuese që lidhen me mjetet me dy rrota.

“Kanë qenë të përfshira edhe fushatat që lidhen me mjetet me dy rrota”, thuhet në përgjigjen e Policisë së Kosovës.

Të dhënat e publikuara nga policia tregojnë se siguria e drejtuesve të motoçikletave dhe mjeteve të tjera me dy rrota mbetet një nga sfidat në trafikun rrugor, veçanërisht për shkak të pasojave të rënda që mund të kenë aksidentet me këto mjete.


Mos i humb

- [Një veturë e FSK-së përfshihet në një aksident trafiku në kryeqytet \(Foto\)](#)



- [“Ndryshoi jetën time”, ushtari i KFOR-it kujton momentin e hyrjes në Kosovë 25 vjet më parë](#)







- [“1 ke 30 minuta... Koha po kalon, kanë mbetur dhe 28 minuta”/ Kush është komandanti gjerman, që i deboi nga Prizreni ushtarët serbë?](#)




- [Shoferi i dehur gjobitet 2 herë, brenda pak minutash, për tejkalim shpejtësie](#)




- [Hajdari: Roli i Avokatit të Popullit të mos involvohet në procedura gjyqësore](#)



- [AKB: Rreth 40 për qind të bizneseve s'e përdorin arkën fiskale në mënyrën e duhur](#)



- [Aksidenti i rëndë në autostradën "Ibrahim Rugova", të lënduarve po iu ofrohet ndihma mjekësore](#)



[Facebook](#)[Follow](#)[Instagram](#)

Të fundit nga Lajme

-  [09:07 / E Hënë, 07 Shtator](#)

[Dogana e Kosovës me kontrolle për zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare](#)

-  [09:06 / E Hënë, 07 Shtator](#)

[Tentativë vrasjeje në Klinë, i dyshuari dërgohet në psikiatri](#)

 [28.09.2019 11:38:50](#)

-  [09:04 / E Hënë, 07 Shtator](#)

[Dyshohet se një burrë kreu sulm seksual ndaj një burri në Prishtinë](#)



- [08:59 / E Hënë, 07 Shtator](#)

[Një shtetase e huaj kapet me substanca narkotike në Prishtinë, ishte duke shqetësuar qytetarët](#)



- [08:45 / E Hënë, 07 Shtator](#)

[Sot bëhen 36 vjet nga shpallja e Kushtetutës së Kaçanikut](#)



- [08:30 / E Hënë, 07 Shtator](#)

[“Ora e Pritjes” nis numërimin mbropa edhe në Kaçanik](#)

TEL Redaksia: +383 (0) 48 36 36 39 | Marketing: +383 (0) 49 686 666

EMAIL info@indeksonline.net | marketing@indeksonline.net

 Indeksonline.net



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.